



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE

**ORGANIZON**

**KONFERENCË SHKENCORE KOMBËTARE**  
**ARRITJE DHE SFIDA NË FUSHËN E STUDIMEVE**  
**SOCIOLOGJIKE NË SHQIPËRI: PROF. DR. ZYHDI DERVISHI,**  
**PROTAGONIST DHE MODEL I NJË STUDIUESI TË SUKSESSHËM**



**31 MAJ 2019**

**SALLA E AMFITEATRIT**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE**  
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", Korçë**

## **Thirrje për pjesëmarrje në konferencë**

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE, UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË, NË BASHKËPUNIM ME DEPARTAMENTIN E SOCIOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, UNIVERSITETIN “HASAN PRISHTINA” PRISHTINË, ORGANIZOJNË KONFERENCË SHKENCORE ME TEMË: **ARRITJE DHE SFIDA NË FUSHËN E STUDIMEVE SOCIOLOGJIKE NË SHQIPËRI: PROF. DR. ZYHDI DERVISHI, PROTAGONIST DHE MODEL I NJË STUDIUESI TË SUKSESSHËM****

### **Qëllimi i konferencës**

Kjo konferencë shkencore synon të bashkojë studiuesit e shkencave shoqërore, sociologjike për të diskutuar dhe këmbyer përvoja dhe ide mbi problemet, sfidat dhe përparësitë e kërkimit shkencor në këto fusha.

Konferencë ka si qëllim të bëjë një analizë të arritjeve në fushën e studimeve shoqërore, sociologjike pas vitit 1990 deri në ditët tona, duke iu referuar veprimtarisë kërkimore shkencore dhe botimeve të sociologut bashkëkohor Zyhdi Dervishi, profesor në Universitetin e Tiranës dhe profesor i ftuar i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

Profesor Dervishi është autor i shumë studimeve sociologjike për profilet kryesore të zhvillimit të shoqërisë shqiptare që kanë të bëjnë me shkallën e lartë të tjetërsimit të shqiptarëve dhe me përshtatjen e metodave kërkimore sociologjike për studimin e realitetit shqiptar, me veçoritë e studimit të mendësive të shqiptarëve dhe me etikën e kërkimeve, me ndryshimet kulturore dhe të familjes, me veçoritë origjinale të komunikimit simbolik dhe me konfliktet e natyrave të ndryshme, me altruizmin dhe vullnetarizmin, me rrjedhojat sociale komplekse të konsumit të lëndëve narkotike, të pijeve alkoolike nga të rinjtë, me papunësinë e vajzave dhe të grave, me realitetet dhe sidomos ato me paragjykitime politike, me

profilet sociale të zhvillimit të shkencave në shoqërinë shqiptare dhe me shqetësimet psikokulturore të adoleshentëve etj.

Rezultatet e këtyre studimeve origjinale janë publikuar në më shumë se 70 artikuj shkencorë të botuar në Shqipëri dhe në vende të tjera, si Italia, Rumania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj., në 17 tekste sociologjike për studentët, nxënësit e shkollave të mesme dhe monografi të botuara në Shqipëri, në Gjermani etj., në dy revista shkencore sociologjike (“Pajtimi” dhe “Lente Sociologjike”), që prof. Zyhdi Dervishi ka drejtuar për 14 vjet me statusin e kryeredaktorit.

Puna e tij akademike, kërkimore shkencore në fushën e sociologjisë, por edhe më gjerë në shkencat shoqërore, sot vlerësohet si një shembull dhe model për studiuesit e rinj.

Qëllimi kryesor i kësaj konference është të mbledhë së bashku studiues të rinj dhe ata me përvojë të shkencave shoqërore e sociologjike, të interesuar për të prezantuar dhe diskutuar rezultatet e punës së tyre kërkimore dhe profesionale në një panel të veçantë me studiuesin Zyhdi Dervishi, i cili me studimet e tij ka krijuar dhe po u përcjell brezave të rinj përvojën origjinale të kërkimeve shkencore konkrete në terrenin e shoqërisë shqiptare. Gjithashtu, pjesëmarrësit janë të ftuar të shtjellojnë problemet thelbësore që hasen sot në punën akademike dhe kërkimore-shkencore gjatë procesit të studimeve shoqërore në realitetin shqiptar.

Në këtë konferencë janë të ftuar të marrin pjesë pedagogë me përvojë, sociologë të rinj, specialistë të pedagogjisë, doktorantë të fushës së sociologjisë dhe studentë të ekselencës që ndjekin studimet në programet “master i shkencave” në sociologji.

### **Fushat përparësore të studimit për përgatitjen e kumtesave:**

- Veçori të metodave të kërkimit sociologjik në shoqërinë shqiptare.
- Sociologji kulture
- Sociologji e emigracionit
- Sociologjia e familjes

- Sociologji e vullnetarizmit
- Sociologjia e ndërveprimit, e komunikimit simbolik
- Studime gjinore
- Sociologji shkence
- Sociologjia e konflikteve
- Profile didaktike të mësimdhënies së sociologjisë
- Interferime të mendimit sociologjik dhe poetik

### **Gjuha zyrtare e konferencës: Gjuha shqipe**

#### **Data me rëndësi:**

- Pranimi i abstrakteve: 02 maj 2019
- Dërgimi i kumtesave të plota: 10 maj 2019
- Dërgimi i programit të plotë: 25 maj 2019
- Zhvillimi i Konferencës: 31 maj 2019

#### **Botimi**

Të gjitha punimet e prezantuara do të botohen në një numër special dedikuar kësaj konference.

#### **Udhëzime për shkrimin e abstraktit**

Abstraktet duhet të dërgohen në gjuhën shqipe.

Format A4, marxhina lart-poshtë 2.5 cm, majtas djathtas 2.5cm, (normal)

- Titulli i punimit shqip: Font (16pt Times New Roman, bold, në qendër )
- Emri i autorit ose i autorëve (Me shkronja të mëdha, 12pt Times New Roman, në qendër)
- Departamenti, Fakulteti, Universiteti: 12pt Times New Roman, në qendër
- E-mail: 12pt Times New Roman, në qendër

- Abstrakti: Teksti 200-250 fjalë, 12pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet
- Abstrakti duhet të jetë në përputhje me një nga fushat e studimit, të përmbajë metodologjinë e përdorur, sugjerimet e mundshme brenda fokusit të studimit dhe referencat nëse ka.
- Fjalë kyç: 5-7 fjalë, 12pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dyja skajet.
- Abstraktet mund t'i dërgoni në mënyrë elektronike në adresën e poshtëshënuar:  
e-mail:

**Person kontakti:**

*Dr. Maria Dojçe, e-mail: [maria.dojce@gmail.com](mailto:maria.dojce@gmail.com)*

**Shënime të rëndësishme**

- Kumtesat duhet të jenë origjinale, të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi.
- Kusht i domosdoshëm për botimin e kumtesës është pjesëmarrja e autorëve (në rastin e bashkautorësisë, të paktën një nga autorët duhet të jetë pjesëmarrës).
- Në vazhdim do të njoftoheni rreth udhëzimeve për punimin e plotë.

**KOMITETI ORGANIZUES I KONFERENCËS**